



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.20

Prill 2005

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

RAPORT

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE PËR MUAJIN MARS 2005

Qendra e Studimeve Parlamentare, në kuadrin e projektit "Rritja e Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Legjislativ" iniciuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare dhe programi i Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (Soros) dhe me mbështetjen financiare të këtij të fundit, gjatë muajit mars, 2005, ka monitoruar veprimtarinë e dy komisioneve të përhershme parlamentare, lidhur me performancën legjislative dhe nivelin e konsultimit dhe pjesëmarrjes së grupeve të interesit dhe publikut në përgjithësi gjatë procesit legjislativ në Kuvend.

I. Monitorimi i Komisionit për Çështjet Ligjore, Adminis-

tratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Seancat e zhvilluara / Kohëzgjatja e mbledhjeve

Gjatë muajit mars KÇLAPDNJ ka zhvilluar 11 mbledhje, të cilat kanë qenë të parashikuara në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Mbledhjet kanë qenë të hapura dhe në të shumtën e rasteve ka qenë e pranishme dhe media. Kohëzgjatja mesatare për një mbledhje ka qenë rreth 62 minuta dhe me një kohëzgjatje totale mujore të veprimtarisë legjislative të Komisionit prej 11 orësh e 30 minuta. Mesatarisht mbledhjet fillojnë me 10 minuta vonesë nga orari i parashikuar.

Çështjet e trajtuara në

(Vijon në faqen 4)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin mars 2005

faqe 1-3

2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

faqe 3

3. Raport nga monitorimi i veprimtarisë së komisioneve parlamentare për muajin mars 2005

faqe 1,4-5

4. Ligjet e miratuara nga Kuvendi mars 2005

faqe 4, 10

5. Kalendarit 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë 25 prill - 16 maj 2005

faqe 6-9

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave mars 2005

I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 25.3.2005

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për miratimin e metodikës "Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësive paguese për sigurimin e jetës dhe të jojetës së shoqërive të sigurimit, si edhe elementët që e përbëjnë atë".

(Vijon në faqen 2)

Ligje të miratuara nga Kuvendi gjatë muajit mars 2005

Ligjin nr.9349, datë 3.3.2005 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik Arab për projektin e rehabilitimit të ujitjes (Faza III)";

Ligjin nr.9350, datë 3.3.2005 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë

(Vijon në faqen 10)

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj, Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare.

Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike

(Vijon në faqen 10)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

2. Për kriteret dhe procedurat e licebsimit të agjentëve në sig-funksionimit të këshillit të Lartë të Arkivave.
3. Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të këshillit të Lartë të Arkivave.
4. Për miratimin e rregullores së Organizimit e të funksionimit qendror të ekspertizës, pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave.
5. Për miratimin e rregullores së organizimit e funksionimit të komisionit të deklasifikimit dhe të zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror", pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave.
6. Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të komisionit të përhershëm të ekspertëve, pranë Drejtorisë së përgjithëshme të Arkivave.
7. Për kriteret e pranimit të nënoficerëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
8. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ujësjellësave ndaj KESH, sha-së, dhe të tretëve, për tremujorin e parë të vitit 2005.
9. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Delvinës, të qarkut të Vlorës.
10. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Laçit, të qarkut të Lezhës.
11. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Bulgarecit, të qarkut të Korçës.
12. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Kolonjës, të qarkut të Fierit.
13. Për miratimin e listës së

inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Fierzës, të qarkut të Kukësit.

14. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Ndoc Deda (Gjetja).

15. Për miratimin në parim të protokollit të sesionit të nëntë të komitetit të përbashkët ndërqeveritar shqiptaro-grek, për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe tekniko-shkencor.

16. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për fiancimin e zgjedhjeve parlamentare, 2005.

II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 31.3.2005 **PROJEKTLIGJE**

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit, në det të hapur.

- Në këtë marrëveshje përcaktohen fushat e aplikimit, që janë anijet e peshkimit të cilat operojnë në det të hapur, përgjegjësitë e shtetit flamurbajtës, detyrimi për mbajtjen e regjistrave të anijeve të peshkimit, bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacioneve mbi bojën e matricave të FAO-s, vendimet dhe mënyra e marrjes së tyre, si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

2. Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nënpunësit civil".

- Ndryshimet kryesore konsistojnë në zgjerimin e fushës së veprimt të ligjit në fuqi, për disa kategori të tjera të administratës publike, në përmirësimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, në detyrimin e institucioneve për hartimin e planit vjetor të pranimeve dhe mbajtjes së

dosjeve të personelit, në disa procedura të konkurimit, etj.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 31.3.2005

1. Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigones, Finiqit dhe Butrintit.

2. Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.

3. Për trajtimin e punojësve civilë që dalin të papunë nga reforma në shtëpinë e pushimit të ushtarakeve në Durrës.

4. Për miratimin e listës së inventarit dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të zyrave të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dega Berat, Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor të këtij rrethi.

5. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën e Cërrikut, të qarkut të Elbasanit.

6. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën e Kozarës, të qarkut të Beratit.

7. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën e Bushatit, të Qarkut të Shkodrës.

8. Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2003, në projektin "Furnizimi me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut- Bistrice II-fiancimi i përzier".

9. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar në pro-

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

jektin "Shkarkimi i ujrave të zeza, Korçë III".

10. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 1999, në projektin "Shtesë fondesh për furnizimin me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut – Bistrica II-fiancimi i përzier".

11. Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/6 KV, Mamurras.

12. Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për prodhimin e veshjeve ushtarake, të artikujve për fjetje he atyre të saraçeri8së për nevojat e veta.

13. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të dr. Adrian Osmanllin jashtë shtetit.

14. Për lejimin e presidencës të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë, për rikonstrukcionin e pjesshmë të godinës së këtij institucioni".

15. Për lejimin e Minsitrisë së Shëndetësisë të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për furnizimin e disa sporteve me pajisje të hemodializës.

16. Për emërim në detyrë.

17. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të Kombinatit Energjistik, Elbasan, ndaj KESH, shasë.

Të ndryshme

Informacion: Për punën e bërë nga Komisioni Qendror i Statutit të Dëshmorit të Atdheut për vitin 2004.

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë www.parlament.al

Presidenca www.president.al

Këshilli i Ministrave www.keshilliministrave.al

Ministria e Financave www.min.fin.gov.al

Ministria e Mbrojtjes www.mod.gov.al

Ministria e Mjedisit www.moe.gov.al

Ministria e Shëndetësisë www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik www.mpo.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme www.mfa.gov.al

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
www.mtt.gov.al

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
www.mbu.gov.al

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
www.mkrs.gov.al

Ministria e Industrisë dhe Energjistikës
www.meep.gov.al

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
www.mrrtt.gov.al

Ministria e Ekonimisë dhe Zhvillimit
www.minek.gov.al

Ministria e Integrimit European
www.mie.gov.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

RAPORT

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE PËR MUAJIN MARS 2005

(Vijon nga faqja 1)

mbledhjet e komisionit

Në 11 mbledhjet e zhvilluara gjatë muajit mars janë shqyrtuar 12 projektligje: Nga këto:

- 5 janë ratifikime marrëveshesh;
- 3 janë projektligje që bëjnë rregullime tërësore;
- dhe 4 janë projektligje që propozojnë ndryshime në ligjet ekzistuese.

Nga 12 projektligjet e shqyrtuara 2 janë me iniciativë të deputeteve të veçantë ose grup deputetësh: "Pr/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr.8556, datë 18.10.1999 dhe me ligjin nr.8781, datë 3.05.2001". Pr/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8204, datë 10.04.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8279, datë 15.01.1998 ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001".

Të gjitha projektligjet me përjashtim të Projektligjit "Për konfliktin e interesave" janë përfunduar (miratuar) në një mbledhje të komisionit. Ndërsa Pr/ligji "Për konfliktin e interesave" është shqyrtuar dhe është miratuar nga komisioni në katër mbledhje të tij.

Konsultimi, ekspertiza dhe burimet e informacionit

Në 11 mbledhjet e zhvilluara, për të mbrojtur propozimet ligjore dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të deputetëve, kanë qënë të pranishëm përfaqësues të qeverisë. Në përgjithësi, qeveria është përfaqësuar me drejtuesit dhe specialistët e sektorëve përkatës të ministrisë që është marrë kryesisht me përgatitjen e projektligjit. Në disa mbledhje ka qënë i pranishëm edhe ministri i shtetit z.Marko Bello kryesisht për të mbrojtur "Për konfliktin e interesave". Në një mbledhje ishin të pranishëm përfaqësues të Komisionit të Monitorimit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës me të cilët u zhvillua një takim dhe u bisedua mbi veprimtarinë e Kuvendit në përgjithësi dhe të KÇLAPDNJ në veçanti.

Në mbledhje kanë qënë të pranishëm dhe këshilltarë të Kuvendit, që mbulojnë këtë Komision. Në shqyrtimin e projektligjeve në këto mbledhje nuk rezultoi të jenë zhvilluar seanca dëgjimi me grupe interesi ose me përfaqësues të komunitetit akademik. Pra, burimi i informacionit dhe konsultimit, gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komision ka qënë ai i Qeverisë dhe i Kuvendit.

Diskutime/Amendamente të bëra nga deputetët

Nga 19 deputetë të Komisionit, 18 anëtarë kanë propozuar amendamente në projektligjet që kanë qënë në shqyrtim. Nga këta, 8 deputetë kanë propozuar më shumë se dy amendamente dhe 1 deputet nuk ka propozuar asnjë amendament. Mbi 50 % e anëtarëve të Komisionit kanë marrë pjesë aktive gjatë shqyrtimit të projektligjeve. Duke vlerësuar pjesëmarrjen në diskutim dhe amendamentet e propozuar të krijohet përceptimi që rreth 30 % e anëtarëve të Komisionit kanë një njohje paraprake të projektligjeve nëpërmjet konsultimeve që mund të kenë zhvilluar jashtë mbledhjes së komisionit. Deputetët janë më aktiv në shqyrtimet e projektligjeve në tërësi ndërsa konstatohet një mungesë njohjeje dhe pjesëmarrjeje në projektligjet e tjera siç janë projektligjet për ndryshime apo shfuqizime dispozitash të veçanta dhe në veçanti projektligjet për ratifikime marrëveshesh, për aderime në konventa etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve konstatohet një pjesëmarrje më aktive e relatorëve të projektligjeve të ndryshme. Ndryshimi i ri që ka sjellë rregullorja e re e Kuvendit ka bërë që deputetët e caktuar për relatimin e projektligjeve të bëjnë një konsultim dhe vlerësim më të plotë të projektligjeve të paraqitura. Megjithatë ka edhe raste kur relatorët thjesht lexojnë materialet e përgatitura nga specialistët.

Kontrolli parlamentar/ Çështje të tjera

Përsa i përket kontrollit parlamentar, një tjetër funksion thelbësor ky i një Komisioni në Kuvend, KÇLAPDNJ ka zhvilluar tre seanca dëgjimore:

1. Seancë dëgjimore publike për Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit
2. Seancë dëgjimore publike për Raportin e Këshillit të Ministrave "Për gjendjen e shërbimit civil".
3. Seancë dëgjimore publike për raportin vjetor të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

KÇLAPDNJ, në mbledhjen e datës 7.03.2005, zhvilloi seancën dëgjimore publike "për Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2004". Në seancën dëgjimore morën pjesë 90% e anëtarëve të KÇLAPDNJ. I pranishëm ishte edhe Avokati i Popullit z.Ermir Dobjani si dhe media të ndryshme. Komisioni dëgjoi raportimin e bërë nga Avokati i Popullit z. Ermir Dobjani. i cili bëri një ekspozë të zgjeruar

(Vijon në faqen 5)

RAPORT

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE PËR MUAJIN MARS 2005

(Vijon nga faqja 4)

të punës së këtij institucioni të pavarur në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij.

Pas raportimit, deputetët i drejtuan pyetje Avokatit të Popullit, më pas diskutuan rreth raportit vjetor për veprimtarinë e këtij institucioni. Në përfundim të diskutimeve të seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni hartoi dhe miratoi një projektrezolutë për vlerësimin e punës së këtij institucioni, e cila më pas u depozitua sipas procedurës për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Në seancën dëgjimore publike të datës 21.03.05 për Raportin e Këshillit të Ministrave "Për gjendjen e shërbimit civil" anëtarët e Komisionit u njohën me një raport të përgjithshëm të veprimtarisë së këtij institucioni prezantuar nga Ministri i Shtetit z. Marko Bello. Deputetët i drejtuan pyetje ministrit kryesisht lidhur me bashkëpunimin që ka Departamenti i Administratës Publike me Komisionin e Shërbimit Civil si dhe mbi rregullimet e reja ligjore për përmirësimin e legjislacionit ekzistues. Në përfundim të diskutimeve Komisioni hartoi dhe miratoi një projektrezolutë për vlerësimin e punës së këtij institucioni, e cila më pas u depozitua sipas procedurës për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Më datë 29.03.05 KÇLAPDNJ zhvilloi një tjetër seancë dëgjimore publike për raportin vjetor të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ku i pranishëm ishte kryetari i KQZ-së z. Ilirian Celibashi si dhe media të ndryshme. Edhe në këtë seancë dëgjimore munguan përfaqësues të OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit. Në këtë seancë anëtarët e Komisionit u njohën me një raport të përgjithshëm të veprimtarisë së KQZ-së gjatë vitit të kaluar si dhe masat e marra për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2005. Deputetët i drejtuan pyetje kryetarit të KQZ-së lidhur me problemet e vërejtura gjatë zgjedhjeve të kaluara si dhe masat e marra për zbatimin e Kodit Zgjedhor. Nga të gjithë pjesëmarrësit u evidentua rëndësia që kanë zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe dhe u kërkua që të ketë një angazhim maksimal të KQZ-së për krijimin e infrastrukturës së nevojshme zgjedhore me synim realizimin e zgjedhjeve të drejta sipas standardeve demokratike.

Çështje të tjera që janë shqyrtuar në Komision gjatë muajit shkurt kanë qënë:

1. Takim i Komisionit me bashkëraporterët e Komisionit të Monitorimit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës për Shqipërinë.

2. Mendim kërkuar nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese për pr/ligjin "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve".

Pjesëmarrja e deputetëve

Nga 11 mbledhje të Komisionit të zhvilluara gjatë muajit mars, 3 deputetë kanë marrë pjesë vetëm në 30% të mbledhjeve të zhvilluara, 4 deputetë kanë marrë pjesë në 60% të mbledhjeve, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve kanë marrë pjesë rregullisht në mbledhje. Por vetëm 3 deputetë nga 19 anëtarë që ka Komisioni, kanë marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e komisionit.

Ka raste kur deputetët vijnë me vonesë dhe largohen nga mbledhja pa u mbyllur ajo megjithatë, edhe këta deputetë firmosin procesverbalin e prezencës në mbledhje. Gjatë këtij muaji janë evidentuar 6 raste kur procesverbali i prezencës në mbledhje është firmosur edhe nga ata deputetë që kanë munguar gjatë zhvillimit të mbledhjes.

Përsa i përket i procedurës së zhvillimit të mbledhjeve në përgjithësi deputetët i janë për mbajtur kerkesave që përcakton rregullorja e re për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Shqipërisë. Të gjitha mbledhjet kanë filluar në momentin kur është plotësuar numri i nevojshëm (kuorumi) për fillimin e saj. Gjatë muajit mars në katër mbledhje nuk është përmendur miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, ndërsa në rastet e tjera procesverbali është miratuar pa asnjë vërejtje nga deputetët. Deputetët nuk njihen me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, sipas kërkesës së rregullore, dhe në këto kushte ata nuk kanë si ta vlerësojnë atë.

KALENDAR I

3 JAVOR (25 prill - 16 maj 2005) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E Hënë, datë 25. 04. 2005, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Betimi i deputetit Dritëro Agolli.
2. Miratimi i Kalendarit 3 javor të Punimeve të Kuvendit (15 Prill - 16 Maj 2005).
3. Pyetje dhe interpelanca.
4. Raport i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e punës të këtij institucioni.

Data 25 prill - 4 maj 2005

- Veprimtari në komisioneve

1. P/Ligji "Për ratifikimin e konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Hollandës, për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Komisioni i Jashtëm,

Komisioni i Integritit, Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Komisioni i Jashtëm,

Komisioni i Integritit, Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës Amerikane "LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC (LMGI)", për ndërtimin e sistemit të

integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, nënshkruar në Tiranë, më 15 mars 2005".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e

Njeriut, Komisioni i Jashtëm,

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

4. P/Ligji "Për borxhin shtetëror dhe garancitë e huave shtetërore të Republikës së Shqipërisë".

Kom. Përgjegjës: Komisioni i

Ekonomisë dhe Financës

Relator: Ejup Tabaku

5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8492, datë 27.05.1999 "Për të huajt".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Jep mendim: Komisioni për

Sigurinë Kombëtare

6. P/Ligji "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për

Veprimtaritë Prodhuese,

Tregtinë dhe Mjedisin

Relator: Zyhdi Pepa, Maksim Begeja

7. P/Ligji "Për Qiranë Financiare".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për

Ekonominë dhe Financat

Relator: Nazmir Bilani

8. P/Ligji "Për Muzetë".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Edukimin

dhe Mjetet e Informimit Publik

Relator: Agron Tato

9. P/Ligji "Mbi kontrollin e OMGJ-ve".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Relator: Valentin Palaj

10. P/Ligji "Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve".

(Vijon në faqen 7)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 6)

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Jep mendim: Komisioni për Sigurinë Kombëtare

11. P/Vendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 88, datë 8.9.2003 të Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe të pagave të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Relator: Lekë Çukaj

12. P/Ligji "Për përdorimin e mjeteve video mbikqyrjes së hapur në vende publike dhe private, në funksion të sigurisë publike dhe të provës në procesin penal".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

12. P/Ligji "Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr. 8454, datë 4.02.1999, plotësuar me ligjin nr. 8600, datë 10.4.200 "Për Avokatin e Popullin".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

13. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004 dhe ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

14. P/Ligji "Për pronësinë industriale".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

15. P/Vendim "Për ngritjen e kompleksit të Ri Parlamentar".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

16. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" (paraqitur nga deputetët F. Beja dhe T. Dedja).

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

17. P/Ligji "Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kordinues Konsultativ në luftën kundër gjakmarrjes" (2 p/ligje).

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
E Enjte, datë 28.04.2005, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri 60 minuta).

2. Diskutimi në parim i p/ligjeve:

2.1. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin që ndryshon nenet 1 (A) dhe 14 (1) (3) (B) të Marrëveshjes Europiane të 30 Shtatorit 1957, për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) bërë në Gjenevë më 28 Tetor 1993".
2.2. P/Ligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës bimor".

Relator: Valentin Palaj, Zyhdi Pepa

2.3. P/Ligji "Për Efiçencën e Energjisë".

Relator: Durim Hushi, Dilaver Qesja

2.4. P/Ligji "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të"

Relator: Vath Koreshi, Bardhyl Londo

2.5. P/Ligji "Për kompensimin e burgimit të padrejtë".

Relator: Pjetër Arbnori, Nezir Selimi

2.6. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8749, datë 1.03.2001 "Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik".

Relator: Fatmir Xhindi

2.7. P/Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare"

Relator: Fatos Beja, Spartak Braho

(Vijon në faqen 8)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 7)

2.8. P/Vendim: Metodika për vlerësimin e pronës së paluajtshme që kompensohet asaj që do të shërbejë për kompensim.

2.9. P/Vendim "Për ngritjen e komisionit hetimor për taksën e Rrugës Durrës-Kukës".

Datë 4 Maj - 11 Maj 2005

- Veprimtari në Komisione:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor të veprimtari të fqinjësisë "CARDS 2004".

**Komisioni për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e
Njeriut, Komisioni i Jashtëm,
Komisioni i Integritit,
Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë dhe financiare për projektin e ndërtimit të Linjës 400 KV, Tiranë-Podgoricë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH, SHA) dhe Kreditanstalt FUR Wiederaufbau, Frankfurt AM MAIN (KFW), marrëveshjes së garancisë ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt FUR Wiederaufbau, Frankfurt AM MAIN (KFW), si dhe marrëveshjes së arbitrazhit, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike shqiptare (KESH, SHA) dhe Kreditanstalt FUR Wiederaufbau, Frankfurt AM MAIN (KFW).

**Komisioni për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e
Njeriut, Komisioni i Jashtëm,
Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

**Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet
Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut**

4. P/Ligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të

paluajtshme" (Varjanti e ish Komisionit të Bujqësisë dhe Ushqimit).

**Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet
Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut**

5. P/Ligji "Për mbarështimin e blegtorisë".

**Kom. Përgjegjës: Komisioni për
Veprimtaritë Prodhuese,
Tregtinë dhe Mjedisin**

6. P/Ligji "Për Inspektoriatin Shtetëror të Ndërtimit".

**Kom. Përgjegjës: Komisioni për
Veprimtaritë Prodhuese,
Tregtinë dhe Mjedisin**

7. P/Ligji "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë".

**Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet
Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut**

8. P/Ligji "Për Gjuhën Shqipe".

**Kom. Përgjegjës: Komisioni për Edukimin
dhe Mjetet e Informimit Publik
Relator: Luan Rama**

9. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ Kombëtar" (paraqitur nga deputeti Fatos Beja).

**Kom. Përgjegjës: Komisioni
për Sigurinë Kombëtare**

10. P/Ligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 8894, datë 14.5.2002 "Për Agjencinë e trajtimit të kredive", të ndryshuar.

**Kom. Përgjegjës: Komisioni për
Ekonominë dhe Financat**

E Mërkurë, datë 4.05.2005, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri në 60 minuta).

2. Diskutimi në parim i p/ligjeve:

2.1. P/Ligji "Për ratifikimin e konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holland-

(Vijon në faqen 9)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 8)

ës, për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

2.2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

2.3. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës Amerikane “LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC (LMGI)”, për ndërtimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, nënshkruar në Tiranë, më 15 mars 2005”.

2.4. P/Ligji “Për borxhin shtetëror dhe garancitë e huave shtetërore të Republikës së Shqipërisë”.

Relator: Ejup Tabaku

2.5. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”.

2.6. P/Ligji “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”.

Relator: Zyhdi Pepa, Maksim Begeja

2.7. P/Ligji “Për Muzetë”. **Relator: Agron Tato**

2.8. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Relator: Luigj Gjoka

2.9. P/Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. **Relator: Luigj Gjoka**

2.10. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”

2.11. P/Ligji “Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kordinues Konsultativ në luftën kundër gjakmarrjes”.

Votimi i p/ligjeve nen për nen dhe në tërësi në ora 13.00.

E Hënë, datë 9.05.2005, ora 18.00.

-Seancë Plenare

1. Pyetje dhe interpelanca.

2. Raport i Governorit të Bankës së Shqipërisë dhe miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e punës të institucionit.

E Enjte, datë 12.05.2005, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri 60minuta).

2. Diskutimi në parim i p/ligjeve:

2.1. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor të veprimit të fqinjësisë “CARDS 2004”.

2.2. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë dhe financiare për projektin e ndërtimit të Linjës 400 KV, Tiranë-Podgoricë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH, SHA) dhe Kreditanstalt FUR Wiederaufbau, Frankfurt AM MAIN (KFW), marrëveshjes së garancisë ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt FUR Wiederaufbau, Frankfurt AM MAIN (KFW), si dhe marrëveshjes së arbitrazhit, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike shqiptare (KESH, SHA) dhe Kreditanstalt FUR Wiederaufbau, Frankfurt AM MAIN (KFW).

2.3. P/Ligji “Për Qiranë Financiare”.

Relator: Nazmir Bilani

2.4. P/Ligji “Mbi Kontrollin e OMGJ-ve”.

Relator: Valentin Palaj

2.5. P/Ligji “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve”.

2.6. P/Ligji “Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr. 8454, datë 4.02.1999, plotësuar me ligjin nr. 8600, datë 10.4.2000 “Për Avokatin e Popullit”.

2.7. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004 dhe ligjin nr. 9341, datë 10.1.2005”.

2.8. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

E Hënë, datë 16.5.2005, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Pyetje dhe interpelanca.

Ligje të miratuara nga Kuvendi gjatë muajit mars 2005

(Vijon nga faqja 1)

së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe të protokollit të saj”;

Ligjin nr.9351, datë 3.3.2005 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në emër të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, për parandalimin e evazionit fiskal”;

Ligjin nr.9352, datë 3.3.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;

Ligjin nr.9353, datë 3.3.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”;

Ligjin nr.9354, datë 3.3.200 “Për caktimin e zonave zgjedhore”

Ligjin nr. 9355, datë 10. 3. 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Ligjin nr.9356, datë 17.3.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

Ligjin nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”.

Ligjin nr.9358, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për Programin Vjetor Kombëtar të Veprimit, CARDS 2004”;

Ligjin nr.9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e “Konventës europiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”;

Ligjin nr.9360, datë 24.3.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen europiane në plotësim të “Konventës për trafikun rrugor, hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968”, bërë në Gjenevë më 1 maj 1971”;

Ligjin nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundruer, të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension”;

Ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”;

Ligjin nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”. Ligjin nr.9364, datë 31.3.2005 “Për ratifikimin e “Konventës “Për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike, në nivel lokal”;

Ligjin nr. 9365, datë 31.3.2005 “Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës Katolike”;

Ligjin nr.9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Njoftim

(Vijon nga faqja 1)

për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, infomacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e infomacionit të kërkuar.

Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga auto-riteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për infomim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP”.

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org